



Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë,

Duke marrë parasysh:

- Nenin 8 paragrafi 1 nën paragrafin 1.6, Nenin 14 paragrafi 2 nën paragrafi 2.6, Nenet 25 dhe 43 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë nr. 03/L-185;
- Rregullën për vendosjen e Çmimeve të Gjenerimit (Rregulla për Çmimet e Gjenerimit), dhe;
- Aplikacionin e KEK-ut për të Hyrat e Lejuara;

Në mbledhjen e mbajtur më datë 20 qershor 2012 e nxori këtë:

VENDIM

TË APROVOJË TË HYRAT MAKSIMALE TË LEJUARA (MAR) që do të mbulohen nga çmimet e rregulluara të ngarkuara nga operatori i licencuar i Termocentralit të Kosovës A dhe operatori i licencuar i Termocentralit të Kosovës B (Gjeneratorët e Rregulluar) për të furnizuar Furnizuesin e licencuar Publik të Energjisë Elektrike për vitin relevant (tarifor) prej 12 muajve nga 1 prill 2012 deri më 31 mars 2013.

Arsyetim

- I. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka pranuar nga Korporata e Energjisë Elektrike e Kosovës SH.A. (KEK) aplikacionin për aprovim të MAR-it që duhet mbledhur nga Gjeneratorët e Rregulluar nga tarifat dhe taksat e rregulluara që do të hyjnë në fuqi nga 1 qershori 2012.
- II. Në marrjen e vendimit të tij që MAR të rimerret nga Gjeneratorët e Rregulluar, ZRRE ka marrë parasysh dokumentet si në vijim që janë lëshuar dhe publikuar në ueb faqen e saj:
 - Shqyrtimi i gjashtë i tarifave të energjisë elektrike 2012(SHTE6) – Raport konsultativ, KEK Sh.A,
 - Shqyrtimi i gjashtë i tarifave të energjisë elektrike 2012(SHTE6) – Shqyrtimi i komenteve, përgjigjet dhe propozimet e ZRRE-së, lëshuar më 20 qershor 2012.



- III. Duke marrë parasysh dispozitat ligjore të përmendura në hyrje të këtij Vendimi dhe pas shqyrtimit të të gjitha shënimeve dhe dokumenteve përkatëse, Bordi i ZRRE-së ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.
- IV. MAR që do të mbulohet nga Gjeneratorët e Rregulluar për periudhën prej 12 muajve nga 1 prilli 2012 deri më 31 mars 2013 është caktuar në **128,743,724 euro**.
- V. Mbajtësi i licencës për Gjeneratorët e Rregulluar udhëzohet t'i përgatis dhe dorëzoj për aprovim ZRRE-së, brenda 45 ditëve të datës së këtij vendimi, çmimet e saj të propozuara të rregulluara për mbulimin e MAR të përcaktuar me këtë vendim.
- VI. Çmimet e propozuara të rregulluara do t'i përcjellin parimet e vendosura në Rregullin për Çmimet e Gjenerimit.
- VII. Mbajtësit të licencës për Gjeneratorët e Rregulluar do t'i lejohet të mbulojë, në vitet në vazhdim, çdo diferencë në mes të MAR të përcaktuar me këtë vendim dhe atë që do të mbulohet përmes çmimeve të rregulluara të aprovuara, aty ku kjo diferencë është për çmimet e rregulluara që aprovohen për të hyrë në fuqi në një datë më vonë se 1 prill 2012.
- VIII. Ky vendim është lëshuar në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe atë angleze. Në rast të ndonjë mospërputhjeje në mes të përkthimeve, do të mbizotëroj versioni i gjuhës shqipe.
- IX. Ky vendim hyn në fuqi në datën e aprovimit të tij nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë para Gjykatës kompetente kundër këtij vendimi brenda katërmëdhjetë (14) ditëve pas marrjes së saj apo publikimit të saj në ueb faqen e ZRRE-së, cilado të ketë ndodhur e fundit.

Bordi i ZRRE

Enver Halimi, Kryesues

Përparim Kabashi, Anëtar

Blerim Koci, Anëtar

Merita Kostari, Anëtare

Krenar Bujupi, Anëtar